PLANI I INTEGRITETIT TË *ALBCONTROL*

2026 - 2028

(A) P.O.Box 8172, Rinas - Albania, (T) +355 (0) 44542101 (E) albcontrol@albcontrol.al

Albcontrol NIPT M52123451W

Hyrje

Plani i Integritetit në *Albcontrol*, përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që cenojnë integritetin.

Forcimi i integritetit dhe miratimi i masave antikorrupsion, paraqesin një rëndësi të veçantë në kuadër të reformave të administratës publike, prioritet i cili zë një vend kryesor në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Plani Integritetit të *Albcontrol* 2026-2028, përfshin një analizë të vlerësimit të risqeve të integritetit në institucion, si dhe parashikon masa konkrete për zbatim me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës përgjatë arritjes së objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve në *Albcontrol* është kryer bazuar kryesisht në fushat e:

a) burimeve njerëzore;
b) informimit dhe transparencës;
c) prokurimit publik;
ç) menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm;
d) etikës, etj.

Plani i Integritetit në *Albcontrol* ka një rol të rëndësishëm dhe ka si synim:

- Burime njerëzore të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnimet e duhura për t'u rezistuar shkeljeve të integritetit;
- Forcimin e transparencës dhe etikës në institucion;
- Përmirësimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm;
- Plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion.

Nevoja për të vendosur sisteme efektive të forcimit të integritetit është shumë e rëndësishme, me qëllim që të garantohet kryerja e veprimtarisë me etikë, integritet dhe performacë të lartë.

Në këtë mënyrë, *Albcontrol* angazhohet plotësisht për të vijuar me përmirësimin dhe forcimin e integritetit në institucion.

PËRMBAJTJA

I. QËLLIMI

II. OBJEKTIVAT

III. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

IV. QASJA METODOLOGJIKE

V. ANALIZA E OBJEKTIVAVE

VI. RISQET E INTEGRITETIT DHE FAKTORËT

VII. PLANI I VEPRIMIT

VIII. MONITORIMI

IX. REGJISTRI I RISKUT TË INTEGRITETIT

I. QËLLIMI

Plani i Integritetit ka një rol shumë të rëndësishëm për institucionin dhe konkretisht në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës, forcimin e rezistencës institucionale ndaj cënimeve të integritetit, si dhe në përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion.

II. OBJEKTIVAT

Nëpërmjet hartimit të Planit të Integritetit dhe monitorimit të zbatimit të tij, synohet të arrihen këto objektiva:

1) Burime njerëzore të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnimet e duhura të përshtatshme për t`u rezistuar shkeljeve të integritetit;
2) Forcimi i së drejtës për informim dhe i transparencës;
3) Përmirësimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm;
4) Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në *Albcontrol.*

III. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

3.1 Ngritja e Grupit të Punës

Drejtori i Përgjithshëm i *Albcontrol*, me Urdhrin e Brendshëm nr. 1314, datë 21.09.2026 (të ndryshuar), ka ngritur Grupin e Punës "Për hartimin e Planit të Integritetit të Albcontrol 2026-2028".

Grupi i Punës kryesohej nga Drejtori i Divizionit Administrativ dhe kishte në përbërje anëtarë të nivelit drejtues, përgjegjës sektori si dhe specialist nga Sektori i Auditimit të Brendshëm.

Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë dhënë kontribut strukturat përkatëse të brendshme të *Albcontrol*, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

3.2 Baza ligjore

- Ligji nr. 40/ 2024 "Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror "*Albcontrol*"";
- Ligji nr. 9131/ 2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Ligji nr. 23/2026 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike";
- Ligji nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve";
- Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 859, datë 26.12.2024 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 874, datë 29.9.2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike";
- Urdhri nr. 334, datë 7.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore".

3.3 Identifikimi i Risqeve të Integritetit

Gjatë kësaj faze, është kryer identifikimi i risqeve dhe faktorëve të tyre. Me qëllim identifikimin e risqeve dhe faktorëve të tyre, grupi i punës ka kryer një analizë të detajuar duke u koordinuar edhe me strukturat përkatëse përgjegjëse të institucionit.

Mbështetur në bazën ligjore të sipërpëmendur, në llojin e veprimtarisë së institucionit si dhe mënyrës së funksionimit të tij si "ent publik", identifikimi i risqeve është realizuar kryesisht në fushën e: a) burimeve njerëzore; b) informimit dhe transparencës; c) prokurimit publik; ç) menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe d) etikës në institucion.

3.4 Vlerësimi i Risqeve të Integritetit

Kjo fazë përfshin vlerësimin e risqeve të integritetit të identifikuara në fazën e mësipërme.

Grupi i punës ka kryer vlerësimin e risqeve të identifikuara në lidhje me: a) mundësinë e ndodhjes së një risku dhe b) rëndësinë (impaktin) e këtij risku.

Pas përcaktimit të mundësisë së ndodhjes se risqeve dhe impaktit të tyre, është vijuar me renditjen e risqeve, me propozimin e masave konkrete për trajtimin e tyre si dhe me përcaktimin e afateve dhe strukturave përgjegjëse.

3.5 Regjistri i Riskut të Integritetit

Gjatë kësaj faze, grupi i punës ka hartuar Regjistrin e Riskut të Integritetit, për menaxhimin e risqeve të integritetit në *Albcontrol*.

Masat e përcaktuara përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre, përgjatë afatit të monitorimit të Planit të Integritetit.

IV. QASJA METODOLOGJIKE

Metoda e përdorur në vlerësimin e riskut të integritetit në *Albcontrol* është e kombinuar:

- Realizimi i pyetësorit të vetëvlerësimit për punonjës të *Albcontrol*, si metodë sasiore nëpërmjet së cilës kryhet një analizë statistikore e perceptimit të punonjësve për proceset e tyre të punës në tërësi si dhe në veçanti lidhur me kuadrin rregullator mbi integritetin, mbi risqet për korrupsionin, konfliktin e interesit, etikën etj.

- Analiza e të gjitha akteve juridike në fuqi në lidhje me: kuadrin ligjor për integritetin; kuadrin e brendshëm rregullator të *Albcontrol* lidhur me rregullat e përgjithshme dhe normat e sjelljes, si dhe standardet e detyrueshme në përputhje me ligjin për çështje që kanë të bëjnë me integritetin, parandalimin e korrupsionit, të konfliktit të interesave, etj.

V. ANALIZA E OBJEKTIVAVE

Objektivi nr.1

Burime njerëzore të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnimet e duhura të përshtatshme për t`u rezistuar shkeljeve të integritetit:

Forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në *Albcontrol* është shumë i rëndësishëm për të siguruar staf me performancë efikase, që reflekton transparencë dhe përgjegjshmëri në të gjitha nivelet.

Në këtë drejtim, synohet të vijohet me një proces transparent dhe të drejtë, për plotësimin e vendeve vakante, duke u mbështetur në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë.

Gjithashtu nëpërmjet këtij objektivi synohet kryerja e vazhdueshme e trajnimeve me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, njohja në vijimësi me rregullat e etikës si dhe përmirësimi i njohurive të punonjësve sipas fushës përkatëse të veprimtarisë, me qëllim arritjen e një përformance sa më të lartë.

Objektivi nr.2

Forcimi i së drejtës për informim dhe i transparencës:

Forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, përbën një ndër objektivat kryesor që synohet të përmbushet. Ky objektiv paraqet një rëndësi thelbësore, për arsye se nëpërmjet një procesi transparent, garantohet llogaridhënia dhe rritet besueshmëria mbi veprimtarinë e institucionit.

Albcontrol siguron vazhdimisht transparencën e duhur mbi aktivitetin e tij operacional dhe organizativ. Gjithsesi, rritja dhe përmirësimi i transparencës së institucionit, me anë të zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të së drejtës së informimit, si dhe të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucional, janë pikësynim i qartë në këtë plan veprimi.

Në faqen zyrtare të *Albcontrol* publikohen qoftë të dhënat subjekt i programit të transparencës, qoftë informacione apo dokumente me karakter informues, siç mund të jenë raporte periodike monitorimi apo aktivitete të ndryshme.

Për sa më sipër, nisur nga rëndësia e këtij objektivi, synohet që edhe në vijim të sigurohet garantimi i transparencës dhe i së drejtës për informim ndaj publikut.

Objektivi 3

Përmirësimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm:

Në *Albcontrol*, rëndësi të veçantë zënë procedurat mbi planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit me ekonomi, eficencë dhe efektivitet, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së *Albcontrol*, zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, kryerja, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i veprimtarisë së menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit si dhe auditimit të brendshëm, zbatohen në *Albcontrol* konform legjislacionit, standardeve dhe procedurave përkatëse.

Pëcaktimi i përmirësimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm si një objektiv specifik në Planin e Integritetit, bëhet me qëllim përforcimin e integritetit të punonjësit në kryerjen e detyrës gjatë planifikimit të buxhetit, zbatimit të tij si dhe kontrollit të brendshëm, duke reflektuar korrektësi, drejtësi, standarde të larta të sjelljes profesionale dhe vendimmarrje në zbatim të akteve juridike në fuqi.

Objektivi 4

Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në *Albcontrol:*

Kuadri rregullativ lidhur me standardet e etikës në administratën publike, parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit, luftën ndaj korrupsionit si dhe qasjes së shërbimit në kushtet e transparencës dhe llogaridhënies, përbëhet nga ligjet përkatëse si dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tyre.

Së brendshmi, në *Albcontrol*, operohet me procedura/rregullore të posaçme, të cilat miratohen nga Titullari si dhe përditësohen në rast ndryshimesh ligjore.

Në këtë kuadër, forcimi i integritetit në *Albcontrol*, synohet të arrihet edhe nëpërmjet një kuadri rregullator të plotë e të përditësuar.

Në këtë mënyrë, rast pas rasti, punonjësit do t`u referohen procedurave përkatëse të miratuara së brendshmi për çdo problematikë të hasur në rast të dyshimit për konflikt të interesit, shkeljes së normave të etikës, iniciativës për sinjalizim të korrupsionit, cënimit të integritetit të tyre etj.

VI. RISQET E INTEGRITETIT DHE FAKTORËT E TYRE

Në bazë të ligjit nr. 40/2024 "Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror "*Albcontrol*"", nga data 01.01.2026, *Albcontrol* funksionon si ent publik, jobuxhetor, veprimtaria e të cilit përbën shërbim publik dhe kryhet nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për çështjet e transportit ajror.

Misioni i *Albcontrol* është të garantojë shërbime të sigurta dhe cilësore të lundrimit ajror, për të gjithë përdoruesit e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Vizioni i *Albcontrol* është të jetë një Ofrues i Shërbimeve të Lundrimit Ajror bashkëkohor, në aplikimin e teknologjive të së ardhmes, duke synuar garantimin e shërbimeve me cilësi të lartë, siguri, ndjeshmëri ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe mbështetur në burime njerëzore të kualifikuar, për t'iu përgjigjur në kohë rritjes dinamike të trafikut ajror dhe kërkesave të Qiellit të Përbashkët Evropian.

Albcontrol zbaton legjislacionin ndërkombëtar në fuqi, marrëveshjet shumëpalëshe/ dypalëshe dhe parimet e rregullat ndërkombëtare në zbatim të këtij legjislacioni si dhe aktet juridike kombëtare në fuqi.

Marrëdhëniet e punës për stafin e *Albcontrol* rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa, për aspekte të kualifikimeve dhe të certifikimit të stafit operacional dhe atij teknik, zbatohen aktet nënligjore në fuqi dhe procedurat/manualet e miratuara në zbatim të tyre.

Albcontrol është subjekt i legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe legjislacionit për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut nga ana e Grupit të Punës, rezultatet e këtij procesi janë zbërthyer në Regjistrin e Riskut të Integritetit në *Albcontrol* (dokumenti bashkëlidhur).

Risqet e integritetit, janë analizuar nga strukturat sipas fushës përkatëse në *Albcontrol,* duke cilësuar burime të riskut shtyllat kryesore si: burimet njerëzore, të drejtën e informimit dhe transparencën, planifikimin e buxhetit, prokurimin publik, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, standardet e etikës, sinjalizimin dhe luftën ndaj korrupsionit si dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Faktorët e riskut janë kategorizuar kryesisht si: operacional, i etikës, i integritetit, i përputhshmërisë (rregullator) dhe reputacional.

Hartimi dhe miratimi i regjistrit të risqeve (me masa zbatuese që do të ndiqen nga struktura të caktuara konform afateve të miratuara), do të pasohet nga një monitorim i vazhdueshëm, që do të pasqyrojë zbatimin e masave dhe nevojat e parashikimeve në periudhën pasuese.

VII. PLANI I VEPRIMIT

Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së çdo punonjësi, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi si dhe forcimin e integritetit në institucion, nevojitet sensibilizimi dhe përgjegjshmëria e punonjësve të *Albcontrol* dhe konkretisht të mbahet në konsideratë që:

- Në çdo rast, çdo punonjës i *Albcontrol* të veprojë me integritet të lartë moral e profesional, në funksion të kryerjes së veprimtarisë administrative;
- Të ruhet paanshmëria, bësueshmëria, transparenca dhe efektiviteti nga ana e punëmarrësve, duke realizuar me disiplinë dhe në kohë detyrat funksionale, në respektim të interesit më të lartë të institucionit;
- Të përdoret në mënyrë efektive koha e punës për realizimin me përgjegjësi dhe korrektësi të detyrave funksionale, duke kontribuar në rritjen e performancës së stafit, si dhe të veprohet në zbatim të legjislacionit, duke siguruar që procedurat administrative të zhvillohen konform afateve ligjore;
- Sjellja e punëmarrësve të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat e parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë punonjësit e punësuar rishtazi që të veprojnë në përputhje me këto vlera;
- Të shmanget çdo situatë konflikti interesi gjatë përmbushjes së detyrave, duke deklaruar interesat private pranë autoritetit përgjegjës dhe të respektohen me rigorozitet dispozitat e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- Të paraqitet një komunikim i karakterizuar nga etika, mirësjellja dhe respekti i ndërsjellë.
- Të nxitet zhvillimi profesional i stafit, përmes ofrimit të mundësive për kualifikim dhe ecuri të vazhdueshme në karrierë;

- Të shmanget nga ana e punonjësve kërkimi/pranimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat me të cilët ka marrëdhënie, i dhuratave/favoreve ose çdo përfitim tjetër, të cilat jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës.

VIII. MONITORIMI

Monitorimi i Planit të Integritetit shërben për të vlerësuar nëse risqet e identifikuara janë menaxhuar në mënyrë të efektive, si dhe për të konstatuar nëse janë realizuar aktivitetet dhe masat e parashikuara në plan.

Për monitorimin e Planit të Integritetit do të përcaktohet Koordinatori i Integritetit, i cili, në bashkëpunim me strukturat e *Albcontrol*, do të raportojë tek Titullari minimalisht 1 (një) herë në vit mbi ecurinë e Regjistrit të Riskut në *Albcontrol*, duke verifikuar: zbatimin e masave të parashikuara, aktivitetet e ndërmarra, objektivat e realizuara dhe ato që mbeten për t`u zbatuar, me rekomandimet përkatëse.

Koordinatori i Integritetit vlerëson edhe mundësinë e ndryshimit/përmirësimit të Planit të Integritetit, duke dhënë rekomandimet përkatëse sipas ecurisë së planit të miratuar.

Raporti i Monitorimit do të publikohet edhe në faqen zyrtare të *Albcontrol*.

IX. REGJISTRI I RISKUT TË INTEGRITETIT